



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 maj 2026
Nr. ref.: AGJ3084/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI151/25

Parashtrues

Fehmi Kameri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [C. nr. 3114/24] në Gjykatën Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Fehmi Kameri me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës sipas shenjës [C. nr. 3114/24] në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. nr. 3114/24] në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores nr. 01/2023 së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 maj 2025, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike, e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 qershor 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI151/25] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues, si dhe përmes vendimit [nr. KSH. KI151/25] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
7. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës përkitazi me regjistrimin e kërkesës së tij.
8. Më 23 prill 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri: (i) deklaroi kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe (iii) ta urdhërojë Gjykatën Themelore, që jo më larg se më 20 nëntor 2026, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se R.K. babai tani i ndjerë i parashtruesit të kërkesës përmes kontratës [nr. ver. 1210/83], të vërtetuar më 14 tetor 1983, para Gjykatës Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), ndau pasurinë e tij për së gjalli ndër djemtë e tij – A.K dhe F.K., duke u ceduar secilit prej tyre nga një të pestën (1/5) e pjesës ideale të pasurisë së paluajtshme, respektivisht ngastrave kadastrale [nr.

2782/1, 2781/2 dhe 2781/1], të evidentuara sipas fletës poseduese [Lp. nr. 3537] në Zyrën Komunale Kadastrale Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: ZKK Gjakovë).

Procedura gjyqësore përkitazi me çështjen kontestuese para vitit 1999

10. Më 20 gusht 1997, babai i parashtruesit të kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale kundër njërit nga të bijtë e tij, A.K., për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat kadastrale [nr. 2782/1, 2781/2 dhe 2781/1] (në tekstin e mëtejshëm: ngastrat e kontestuar), të evidentuara sipas fletës poseduese [Lp. nr. 3537] në ZKK Gjakovë. Po ashtu, i njëjti kërkoi që të bëhej anulimi i kontratës [nr. ver. 1210/83] i 14 tetorit 1983 përkitazi me shpërbërjen e bashkësisë familjare dhe cedimin e pasurisë së paluajtshme, meqenëse konsideronte se ndarja e tillë ishte bërë në kundërshtim me ligjin dhe, si e tillë, nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Andaj, Gjykatës Komunale i propozoi aprovimin e kërkesëpadisë dhe fshirjen e emrit të A.K. nga librat publik në dobi të tij.
11. Më 15 prill 1998, Gjykata Komunale në Gjakovë përmes Aktgjykimit [P. nr. 427/97] vërtetoi pavlefshmërinë e kontratës [nr. ver. 1210/83], të 14 tetorit 1983, për shpërbërjen e bashkësisë familjare dhe cedimin e pasurisë së paluajtshme, ashtu që e njëjta nuk prodhonte më efekt juridik.
12. Gjykata Komunale në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur përkitazi me kontratën e kontestuar gjeti se me rastin e lidhjes së saj nuk ishin respektuar përcaktimet e “*nenit 106 të Ligjit për Trashëgiminë*”. Përkatësisht, Gjykata Komunale argumentoi se kontrata ishte lidhur në mungesë të pjesëmarrjes së fëmijëve të tjerë dhe bashkëshortes së R.K. në cilësinë e ceduesit, e të cilët sipas përcaktimeve ligjore duhej të thirrreshin në trashëgimi. Po ashtu, vërtetimi i së njëjtës nuk ishte bërë në formën të cilën e kërkonte ligji, rrjedhimisht e njëjta është vlerësuar si e pavlefshme në kuptim të “*nenit 109 të LMD-së*”.

Procedura gjyqësore përkitazi me çështjen kontestuese pas vitit 1999 deri më 15 qershor 2008

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 20 tetor 2000, R.K. parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale për vazhdimin e procedurës në kontestin civil sipas shenjës [C. nr. 427/97].
14. Më 6 nëntor 2000, pala e paditur, përkatësisht A.K. parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Qarkut) kundër Aktgjykimit [P. nr. 427/97], të 15 prillit 1998, të Gjykatës Komunale, për shkak të (i) cenimit të dispozitave të procedurës civile, (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 9 maj 2001, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac. nr. 113/2001] prishi Aktgjykimin [P. nr. 427/97], e 15 prillit 1998 të Gjykatës Komunale, ashtu që lëndën e ktheu për rishqyrtim dhe rivendosje tek e njëjta.
16. Gjykata e Qarkut në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur theksoi se Gjykata Komunale nuk kishte hetuar, respektivisht vërtetuar faktet relevante që lidheshin me krijimin e raporteve të reja juridike-civile, si dhe realitetin juridik përkitazi me përmbushjen e kontratës për shpërbërjen e bashkësisë familjare dhe cedimin e pasurisë së paluajtshme, meqenëse kjo e fundit ishte lidhur në vitin 1983, ndërkaq padia ishte paraqitur tek në vitin 1997. Andaj, Gjykata e Qarkut propozoi që në procedurë të rigjykitimit, të bëhet evitimi i shkeljeve procedurale të identifikuara, ashtu që palët e përfshira të deklarojnë shprehimisht aprovimin, respektivisht kontestimin e kontratës së lartcekur.

17. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 17 shtator 2001, R. K. ndërroi jetë.
18. Më 29 mars 2002, Gjykata Komunale mbajti seancën e shqyrtimit kryesor përkitazi me çështjen kontestuese sipas shenjës [C. nr. 213/2001], në të cilën sipas propozimit të përfaqësuesit të R. K., ishte ndërprerë procedura pas vdekjes së evidentuar të këtij të fundit.

Procedura gjyqësore përkitazi me rikonstruktimin e shkresave të çështjes kontestuese pas 15 qershorit 2008

19. Më 24 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës dhe subjektet Sh.K., V.B. dhe A.K. (në tekstin e mëtejshëm: paditësit e tjerë), të cilët rezulton të kenë marrë përsipër procedurën që është zhvilluar nga R.K. – tani i ndjerë, parashtruan kërkesë në Gjykatën Themelore për vazhdimin e procedurës së evidentuar sipas shenjës [C. nr. 213/2001], duke theksuar se edhe pse procedura paraprake e trashëgimisë nuk ka përfunduar, sipas vlerësimit të tyre, janë plotësuar kushtet për procedim të mëtutjeshëm.
20. Më 28 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit e tjerë, parashtruan kërkesë në Gjykatën Themelore për rikonstruktim të lëndës sipas shenjës [C. nr. 213/2001, respektivisht C. nr. 427/97], duke theksuar se pavarësisht kërkesës për vazhdim të procedurës të 24 qershorit 2015, lënda në fjalë nuk është gjetur nga ana e Gjykatës Themelore.
21. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe paditësit e tjerë më 18 janar 2016, respektivisht, 8 mars 2016 dhe 2 qershor 2016, kanë paraqitur urgjencë për caktimin e seancës përkitazi me lëndën sipas shenjës [C. nr. 213/2001], duke qenë se paditësja e parë ishte e sëmure rëndë.
22. Më 4 gusht 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 552/15] vendosi të fillojë procedurën e rikonstruktimit të shkresave të lëndës civile-juridike, sipas shenjës [C. nr. 213/01], ashtu që detyroi palët në procedurë që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të bëjnë dorëzimin e dokumenteve që mungojnë në Gjykatën Themelore.
23. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 19 janar 2017, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit e tjerë kanë paraqitur urgjencë për caktimin e seancës përkitazi me lëndën sipas shenjës [C. nr. 552/2015].
24. Më 4 maj 2017, Gjykata Themelore mbajti seancën e parë përgatitore përkitazi me kërkesën për rikonstruktimin e lëndës sipas shenjës [C. nr. 213/2001], ashtu vendosi që të ndërrohet numri punues të së njëjtës me shenjën [C. nr. 552/15] dhe seanca e radhës të caktohet më 1 qershor 2017. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata Themelore kërkoi që të rregullohet padia në aspektin objektiv dhe subjektiv nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë.

Procedura gjyqësore përkitazi me çështjen kontestuese pas rikonstruktimit të shkresave

25. Më 18 shtator 2017, Sh.K. në cilësinë e palës paditëse dhe trashëgimtares ligjore të R.K., parashtroi në Gjykatën Themelore deklaratën e saj përkitazi me çështjen kontestuese.
26. Më 21 nëntor 2017, Gjykata Themelore, sipas kërkesës së palës së paditur, përmes Aktvendimit [C. nr. 552/15] e ndërpreu procedurën në çështjen juridike-civile, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake trashëgimore në lëndën sipas shenjës [T. nr. 8/17], duke qenë se procedura trashëgimore për të ndjerin R.K. nuk kishte përfunduar ende.

27. Më 22 shkurt 2018, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore pas ndërprerjes duke marrë numrin punues [C. nr. 4/18], e cila ishte shtyrë për 26 mars 2018.
28. Më 28 mars 2018, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore dhe përmes Aktvendimit procedural [C. nr. 4/18], vendosi që të merren provat përmes ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë dhe ndërtimtarisë, ndërsa seanca e radhës u caktua për 15 maj 2018.
29. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se në harkun kohor ndërmjet 15 majit 2018 dhe 6 marsit 2019, ishin mbajtur 4 (katër) seanca, përkatësisht më: (i) 15 maj 2018 – e cila u shty për 5 qershor 2018; (ii) 5 nëntor 2018 – e cila u shty për 17 dhjetor 2018; (iii) 17 dhjetor 2018 – e cila u shty për 31 janar 2019; dhe (iv) 31 janar 2019 – e cila u shty për 6 mars 2019.
30. Më 6 mars 2019, Gjykata Themelore mbajti seancën ku u dëgjua Sh.K. në cilësinë e dëshmitares si palë paditëse në procedurë. Ndërkaq, e njëjta përmes Aktvendimit procedural [C. nr. 4/18] vendosi që të merren provat përmes dëgjimit të dëshmitarëve të tjerë në cilësinë e palëve të paditura, ndërsa seanca e radhës u caktua për 7 maj 2019.
31. Më 7 maj 2019, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore ku u dëgjua parashtruesi i kërkesës dhe F.K. në cilësinë e palës paditëse, sikurse dhe A.K. në cilësinë e palës së paditur. Po ashtu, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit procedural [C. nr. 4/18] vendosi që të merren prova përmes ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë, ndërsa seanca e radhës u caktua për 10 qershor 2019.
32. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se në harkun kohor ndërmjet 10 qershorit 2019 dhe 11 nëntorit 2019, u mbajtën katër (4) seanca, përkatësisht më: (i) 10 qershor 2019 – e cila u shty për 10 korrik 2019; (ii) 10 korrik 2019 – në të cilën ishte lexuar ekspertiza nga lëmi i gjeodezisë, ashtu që u kërkuar plotësimi i së njëjtës, ndërkaq seanca u shty për 9 shtator 2019; (iii) 9 shtator 2019 – u konstatua plotësimi i ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë të dorëzuar më 12 korrik 2019, ndërkaq seanca u shty për 15 tetor 2019; (iv) 11 nëntor 2019 – u lexua rishtazi ekspertiza e 12 korrikut 2019 ashtu që palëve ndërgjyqëse i është mundësuar paraqitja e fjalëve të tyre përfundimtare në formë të shkruar.
33. Më 16 dhjetor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 4/18] (i) pjesërisht aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë; (ii) vërtetoi se Kontrata [nr. ver. 1210/83] e 14 tetorit 1983 përkitazi me shpërbërjen e bashkësisë familjare dhe cedimin e pasurisë së paluajtshme është nule dhe nuk prodhon më pasoja juridike; (iii) vërtetoi se parashtruesi i kërkesës dhe paditësit e tjerë janë pronarë të një të gjashtës (1/6) pjesë ideale në paluajtshmërinë, respektivisht ngastrën kadastrale [P-70705029-2781-2] ZK Gjakovë-qytet; ashtu që detyroi A.K. si i paditur që të drejtën e lartcekur t'ua njoh parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit të tillë; dhe (iv) refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë përkitazi me pjesën e aprovuar deri në lartësinë e kërkesës me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se janë pronarë me nga një të pestën (1/5) të paluajtshmërisë.
34. Gjykata Themelore përmes aktgjykimit të lartcekur konstatoi se me rastin e anulimit të Kontratës [nr. ver. 1210/83] të 14 tetorit 1983, palët ndërgjyqëse, duke qenë se të njëjtit janë trashëgimtarë të ndjerit R.K., të njëjtit sipas dispozitave ligjore trashëgojnë në pjesë të barabarta, respektivisht nga një të gjashtën (1/6) pjesë të paluajtshmërisë, dhe se asnjëri nga këto nuk mundet të përjashtohet nga trashëgimia.

35. Më 17 janar 2020, F.K. në cilësinë e paditësit të pestë parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 4/18] të 16 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe (iv) vendimit për shpenzimet kontestimore.
36. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës krahas me paditësit e tjerë parashtruan ankesë kundër pjesës refuzuese të Aktgjykimit [C. nr. 4/18], të 16 dhjetorit 2019, të Gjykatës Themelore, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe (iv) vendimit për shpenzimet procedurale.
37. Nga shkresat e lëndës rezulton se A.K. në cilësinë e palës së paditur po ashtu parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 4/18] të 16 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
38. Më 26 gusht 2024, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1668/20] (i) refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe A.K., në cilësinë e palës së paditur, duke e vërtetuar pikën II të Aktgjykimit [C. nr. 4/18] të 16 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore; dhe (ii) pranoi si pjesërisht të themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë, duke prishur në pikat III, IV dhe V të po këtij aktgjykimi, ashtu që i njëjti në pikat e tilla kthehet për rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
39. Gjykata e Apelit në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur, sqaroi se prishja e pikave të lartcekura vjen si rezultat i *“paekzaminueshmërisë dhe kundërshtimit me pjesën e arsyetimit të aktgjykimit”*, duke qenë se sipas shkresave të lëndës nuk rezulton se padia e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë të ketë pasur si objekt vërtetimin e të drejtës së pronësisë në një të gjashtën (1/6) pjesë të paluajtshmërisë. Andaj, krahas tejkalimit të kërkesave të paraqitura në petitumin e padisë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë *“nuk ka sqaruar se nga cila bazë kërkohet e drejta në pronë lidhur me paluajtshmërinë lëndore dhe cilat fakte i vlerësoi si vendimtare për të vendosur si në aktgjykimin e atakuar”*.
40. Më 26 shkurt 2025, në procedurën e rivendosjes, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore lidhur me lëndën e parashtruesit të kërkesës, e cila mori numrin punues [C. nr. 3114/24]. Në këtë seancë, u konstatua se Sh. K. në cilësinë e paditëses së parë ka ndërruar jetë. Rrjedhimisht, përmes Aktvendimit procedural [C. nr. 3114/24] dhe sipas përcaktimeve të dispozitës së nenit 277 të Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) u ndërpre procedura në çështjen përkatëse juridike-kontestimore.
41. Më 26 maj 2025, parashtruesi i kërkesës dhe F.K., V.B. dhe A.K., kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore për vazhdimin e procedurës së ndërprerë sipas numrit punues [C. nr. 3114/24], duke theksuar se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e së njëjtës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së si rezultat i mosgjykimit të lëndës së tij në një afat të arsyeshëm kohor nga gjykatat e rregullta, si dhe shkeljen e nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës.

43. Parashtruesi i kërkesës sqaron se procedura e tillë që ka për objekt paluajtshmërinë lëndore është iniciuar nga babai i tij, tani i ndjerë në vitin 1997, dhe se e njëjta ende nuk ka marrë epilog përfundimtar. Po kështu, i njëjti thekson se janë mbajtur më tepër se pesëmbëdhjetë (15) seanca gjyqësore në harkun kohor prej njëzet e tetë (28) viteve prej kur e njëjta është iniciuar, duke rezultuar, sipas tij, në *“zvarritje të pajustificuar, mungesë të vendimmarrjes brenda afatit të arsyeshëm dhe shkeljes së parimit të sigurisë juridike”*.
44. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës sjellë në vëmendje se kontesti i tillë për të cilin pretendon se është nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor, ka krijuar *“pasoja të mëdha për të jo vetëm në aspektin juridik por edhe në aspektin personal, emocional dhe ekonomik”*. I njëjti, në thelb, pretendimin e tillë e ndërlihdh me ndërprerjen e fundit të procedurës nga ana e Gjykatës Themelore, me ç’ rast e njëjta nuk është vazhduar përkundër faktit se i njëjti ka dërguar disa urgjenca.
45. Parashtruesi e kërkesës pretendon se si pasojë e tejzgjatjes së procedurës kontestimore në Gjykatën Themelore, *“[...] mungesa e një vendimi përfundimtar për mbi dy dekada ka ndikuar në pamundësinë për të ushtruar të drejtën mbi pronë në mënyrë të plotë, ka penguar shfrytëzimin ekonomik të saj dhe ka krijuar një gjendje të vazhdueshme pasigurie juridike”*.
46. Përkitazi me pretendimin e tillë, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës së Gjykatës në rastet e ngjashme që lidhen me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, përkatësisht [Kl06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajloviq*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; dhe [Kl164/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023.
47. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë se: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor; si dhe (iii) të detyrohet Republika e Kosovës që parashtruesit t’ia paguajë në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e shkeljes së të drejtave elementare njerëzore, në shumën prej 10,000 € (dhjetë mijë euro).

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]*”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT [e miratuar më 4 nëntor 1950 nga Këshilli i Evropës]

Neni 6

(E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...]”

**RREGULLORE NR. 03/2014 MBI ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
TË GJYKATAVE**

**Neni 32
(Humbja, dëmtimi dhe përtërirja e shkresave të lëndës)**

- 1. Nëse shkresat apo pjesët e caktuara të lëndës humben, dëmtohen apo shkatërrohen, fillon procedura për përtërirjen e shkresave.*
- 2. Pas informimit të kryetarit të gjykatës respektivisht të gjyqtarit mbikqyrës, gjyqtari i lëndës merr vendim për përtërirjen e shkresave të lëndës. Zbatimin e këtij vendimi e bën shefi i ZML-së respektivisht referenti i lartë.*
- 3. Për shkresat e lëndës për të cilat ka përfunduar procedura me vendim të plotfuqishëm, përtërirja e shkresave të lëndës inicohet vetëm nëse ka interes të arsyeshëm. Kryetari i gjykatës përkatësisht gjyqtari mbikëqyrës urdhëron përtërirjen e lëndës sipas detyrës zyrtare apo me kërkesën e palëve ndërgjyqësore.*
- 4. Procedura për përtërirjen e shkresave të lëndës nuk mund të fillohet nëse ka kaluar afati për ruajtjen e këtyre shkresave.*
- 5. Vetëm ato shkresa të lëndës të cilat janë të rëndësishme për procedurën përtërihen.*
- 6. Përtërirja bëhet në bazë të përshkrimit të dokumenteve të humbura, të dëmtuara ose të shkatërruara të cilat gjykata i ka në dispozicion nga regjistri dhe librat ndihmës apo të dhënat e ofruara nga palët ndërgjyqësore, ekspertët, dëshmitarët dhe personat e tjerë që kanë marrë pjesë në procedurë.*
- 7. Kur për dokumentet e humbura, të dëmtuara ose të shkatërruara nuk ka dëshmi të mjaftueshme dhe deklaratat e personave të cekur më lart nuk përputhen, këto veprime do të përsëriten nga gjyqtari i lëndës nëse ende nuk është marrë vendimi i shkallës së parë.*
- 8. Palët deklarohen lidhur me humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e atyre shkresave në bazë të të cilave procedura është duke u zhvilluar dhe njëkohësisht palët ftohen të paraqesin të gjitha të dhënat, procesverbalet, vendimet gjyqësore dhe shkresat tjera që kanë në dispozicion.*
- 9. Vendimi për përtërirjen e shkresave të lëndës në të cilën procedura është në zhvillim e sipër zhvillohet nën numrin e njëjtë në të cilin është regjistruar lënda. 10. Kërkesa dhe vendimi për përtërirjen e shkresave të lëndës në të cilën procedura ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm, shënohen në regjistrin “GJA” dhe pas përtërirjes së shkresave të lëndës, shënohen në regjistrin e duhur me numrin e njëjtë me të cilin është punuar lënda. Në mbështjellësin e shkresave të lëndës vendoset shenja “Shkresa të përtërira”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

48. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
49. Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

Nenit 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

50. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 (Kërkesat individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

51. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata duhet fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, për të parashtruar kërkesën para Gjykatës. Gjykata vëren se procedurat fillestare ishin iniciuar më 20 gusht 1997 nga babai i parashtruesit të kërkesës R.K., i cili kishte ndërruar jetë më 17 shtator 2001. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se hapja e trashëgimisë së babait të parashtruesit të kërkesës rezultoi në këtë përfunduar para 22 shkurtit 2018, kur Gjykata Themelore edhe filloi ta rishqyrtojë çështjen e lartcekur juridike-civile në merita. Rrjedhimisht edhe parashtruesi i kërkesës nga ky moment ka fituar legjitimitetin aktiv në këtë çështje juridike-civile, e cila mori shenjë [C. nr. 4/18].
52. Në kontekst të përcaktimit të statusit të palës së autorizuar, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore kur kishte përcaktuar standardin se për të paraqitur kërkesë para Gjykatës një person duhet të jetë “viktimë” e shkeljes kushtetuese, “direkte” apo “indirekte”. Në kontekst të viktimës indirekte ose të tërthortë, siç është konfirmuar në rastin [KI211/25](#) [parashtrues *Burbuqe Pruthi*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2025], praktika e Gjykatës është posaçërisht e konsoliduar në rrethana të pretendimeve para Gjykatës lidhur me dështimin e shtetit për të përmbushur detyrimet pozitive për mbrojtjen e të drejtës në jetë sipas garancive të nenit 25 [E Drejta për Jetë] të Kushtetutës dhe nenit 2 (E drejta për jetën) të KEDNJ-së (shih, rastet e Gjykatës [KI41/12](#), me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 26 shkurtit 2013, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindërit e të bijës së ndjerë; dhe [KI129/21](#), me parashtruese *Velerda Sopi*, Aktgjykim i 7 marsit 2023, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga vajza e të ëmës së ndjerë). Ngjashëm, Gjykata ka vepruar edhe në kontekst të së drejtës për privatësinë dhe jetën familjare, të

garantuar me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit përkatës (shih, rastin [KI56/18](#), me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindi i të ndjerit). Së fundi, Gjykata ia ka njohur statusin e “viktimës” edhe parashtrueses së kërkesës në rastin KI211/25, e cila ishte në marrëdhënie bashkëshortore me paditësin tashmë të ndjerë, në procedurën kontestimore për shpronësimin e një prone. Parashtruesja e kërkesës në këtë rast kontestonte kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, me ç’ rast pretendonte shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme (shih rastin e Gjykatës, KI211/25, parashtruese *Burbuqe Pruthi*, cituar më lart, paragrafi 45).

53. Prandaj, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë, u është njohur vetëm familjarëve të ngushtë apo personave të afërm, të cilët kanë arritur të dëshmojnë se kanë interes legjitim lidhur me çështjen në fjalë (shih, rastin e Gjykatës KI211/25, parashtruese *Burbuqe Pruthi*, cituar më lart, paragrafi 45 dhe referencat e përdorura aty).
54. Gjykata ka sqaruar, rast pas rasti, që statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë është po ashtu i ndërlidhur me natyrën e të drejtave që kontestohen para Gjykatës, përkatësisht nëse të drejtat përkatëse mund të cilësohen si të drejta të “*transferueshme*” apo jo. Për më tepër, Gjykata vëren se në ato raste kur statusi i viktimës iu ka akorduar të afërmeve, duke i lejuar ata të parashtronin një kërkesë në lidhje me ankesat e tyre, përkatësisht, në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ mori parasysh faktin nëse parashtruesit mund të kishin interes material në bazë të efektit të drejtpërdrejtë në të drejtat e tyre monetare (shih, rastin e Gjykatës KI211/25, parashtruese *Burbuqe Pruthi*, cituar më lart, paragrafi 46 dhe referencat e përdorura aty; si dhe rastin e GJEDNJ-së, [Micallef kundër Maltës](#), nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 48).
55. Në rastin konkret, pasi babai i parashtruesit kishte ndërruar jetë, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore u paraqit si palë paditëse më 22 shkurt 2018, kur edhe rifilloi gjykimi i çështjes kontestimore në merita pas ndërprerjes së procedurës gjyqësore më 21 nëntor 2017 si pasojë e zgjidhjes së çështjes paraprake trashëgimore. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka interes të drejtpërdrejtë përkitazi me pronën kontestuese dhe si pasojë është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë para Gjykatës, sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës 34 (1) (a) të Rregullores së punës.
56. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij specifikon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i tejzgjatjes së procedurës kontestimore lidhur me lëndën civile [C. nr. 3114/24], për vërtetimin e pronësisë në ngastrat e kontestuarra. Ai gjithashtu pretendon se mungesa e një vendimi përfundimtar ia ka mundësuar ushtrimin e të drejtës mbi pronë, e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
57. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
58. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtës në pronë, të garantuar më nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në rastet kur parashtruesit pretendojnë se tejzgjatja e procedurës kontestimore në çështje pronësore përbën një pengesë të vazhdueshme për të gëzuar të drejtën në pronë. Në këto raste, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrim se nuk është

e nevojshme të shqyrtohet ky pretendim sipas nenit 1 (Mbrotja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së [Zanghì kundër Italisë](#), nr. 11491/85, Aktgjykim i 19 shkurtit 1991, paragrafi 23) ose se çështja e tillë është e parakohshme (shih rastin e GJEDNJ-së [Beller kundër Polonisë](#), nr. 51837/99, Aktgjykim i 1 shkurtit 2005, paragrafi 74).

59. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata duhet ta shqyrtojë pranueshmërinë e pretendimit për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në kontekst të kriterit të pranueshmërisë së shterimit të mjeteve juridike, të përcaktuar në nenin 49 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson praktikën e saj gjyqësore, e cila në parim njeh tri kategori të rasteve kur kërkesa e paraqitur mund të shpallet e papranueshme për shqyrtim për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, e ku njëra nga këto raste është kategoria e “*kërkesës së parakohshme*” (shih ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI09/19](#), me parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafët 40-43; [KI179/20](#), me parashtrues *Telekom i Kosovës Sh. A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2021, paragrafi 95; dhe [KI49/22](#), me parashtrues *Zejnel Ninaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 gushtit 2023, paragrafi 59; dhe rastet e GJEDNJ-së [Bilsena Šahman kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), nr. 40110/16, Vendim i 25 prillit 2017 dhe [Alenka Šaver kundër Sllovenisë](#), nr. 18105/13, Vendim i 7 shkurtit 2017).
60. Andaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe vetë Gjykatës në lidhje me kategorinë e kërkesave të parakohshme, duke qenë se kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat e kontestuar është duke u gjykuar ende pranë Gjykatës Themelore, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkeljen e së drejtës në pronë, cilësohet si kërkesë e kategorisë të “*kërkesës së parakohshme*” dhe rrjedhimisht, kërkesa refuzohet në pajtim me nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës (shih rastin e Gjykatës, *mutatis mutandis*, [KI33/25](#), parashtruese *Dobrila Rakić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 shtatorit 2025, paragrafët 86-89).
61. Ndërsa, në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe kohë të arsyeshme, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore për padinë e tij për vërtetim pronësie në ngastrat e kontestuar, e cila ende nuk ka përfunduar, pasi rasti është kthyer në rishqyrtim në Gjykatën Themelore dhe ende pret të vendoset nga kjo e fundit. Gjykata, duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurës, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kushteve të parashikuara me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kushti për paraqitjen e kërkesës brenda katër (4) muajve, pasi lënda është ende në zhvillim e sipër.
62. Përveç kushteve të parashikuara me Ligj, Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë që:

Rregulli 34
(Kriteret e Pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtuesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.
[...]

63. Gjykata thekson se kërkesa përkitazi me pretendimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore në lidhje me lëndën civile [C. nr. 3114/24], përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme, bazuar në kushtet e përcaktuara nga paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës. Përveç kësaj dhe përfundimisht, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të deklarohet e papranueshme në asnjë bazë tjetër, prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme dhe të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

64. Gjykata fillimisht rikujton se më 20 gusht 1997, babai i parashtuesit të kërkesës, R.K., kishte parashtuar padë për vërtetimin e pronësisë në ngastrat e kontestuar, të cilat përmes kontratës ia kishte ndarë në të gjallë dy djemve të tij, A.K. dhe F.K. më 14 tetor 1983. Gjykata Komunale ia kishte vërtetuar pavlefshmërinë e kontratës, por më pas më 9 maj 2001, Gjykata e Qarkut e ktheu në rigjykim lëndën, e cila procedurë u ndërpre më 29 mars 2002 nga Gjykata Komunale, pas vdekjes së evidentuar të paditësit, respektivisht, babait të parashtuesit të kërkesës më 17 shtator 2001. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës së bashku me disa paditës (familjarë të parashtuesit) të tjerë, më 24 qershor 2015, morën përsipër çështjen kontestimore për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat e kontestuar, me shenjë [C. nr. 3114/24] (e evidentuar më parë me shenjë [C. nr. 213/2001]), pas vdekjes së babait të tij R.K., me ç’ rast kërkuar rikonstruktimin e shkresave të lëndës së lartcekur, e cila lëndë më pas, respektivisht, më 4 maj 2017, u evidentua me shenjë [C. 552/15] nga Gjykata Themelore. Gjykata po ashtu rikujton se më 21 nëntor 2017, Gjykata Themelore, me kërkesën e palës së paditur, përmes Aktvendimit [C. nr. 552/15] ndërpreu procedurën në çështjen e lartcekur juridike-civile, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake trashëgimore në lëndën sipas shenjës [T. nr. 8/17], duke qenë se procedura trashëgimore për të ndjerin R.K. nuk kishte përfunduar ende. Procedura trashëgimore sipas shenjës [T. nr. 8/17] rezultoi të ketë përfunduar para 22 shkurtit 2018, kur Gjykata Themelore edhe filloi ta rishqyrtojë çështjen e lartcekur juridike-civile në merita, e cila lëndë mori shenjë [C. nr. 4/18]. Nga shkresat e lëndës rezultoi se në harkun kohor 15 maj 2018 deri më 11 nëntor 2019, u mbajtën rreth 9 (nëntë) seanca gjyqësore, shumica prej të cilave u shtynë, duke mos u mbajtur në datën e përcaktuar/origjinale. Më 26 dhjetor 2019, Gjykata Themelore aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtuesit të kërkesës dhe bashkëpaditësve të tjerë, i cili aktgjykim u prish dhe u kthye në rivendosje nga Gjykata e Apelit më 26 gusht 2024 sipas ankesës së palës paditëse dhe asaj të paditur. Më 26 shkurt 2025, Gjykata Themelore në seancën përgatitore në procedurë të rivendosjes e ndërpreu procedurën gjyqësore në lëndën e lartcekur, e cila kishte marrë numrin e ri punues [C. nr. 3114/24], duke qenë se konstatoi vdekjen e nënës së parashtuesit të kërkesës, respektivisht, paditëses së parë, ndërsa më 26 maj 2025, parashtuesi i kërkesës dhe paditësit e mbetur kërkuar vazhdimin e procedurës së ndërprerë, duke theksuar se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e së njëjtës.
65. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij specifikon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një

proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i tejzgjatjes së procedurës kontestimore për vërtetimin e pronësisë në ngastrat e kontestuar.

66. Gjykata do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për tejzgjatje të procedurës së zhvilluar dhe do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara përmes paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të cilin rast, Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

I. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës

67. Në kontekst, lidhur me të drejtën për nxjerrjen e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm kohor, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, të cilët përcaktojnë që:

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...].

Neni 6

(E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].”

68. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
69. Në rastin konkret, Gjykata vëren se më 20 gusht 1997, babai i parashtruesit të kërkesës, R.K. parashtroi padë në Gjykatën Komunale kundër njërit nga të bijtë e tij, A.K., për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat e kontestuar. Më 22 shkurt 2018 rifilloi procedura gjyqësore në lëndën [C. nr. 3114/24] (e evidentuar më parë me shenjat [C. nr. 213/2001], [C. nr. 552/15] dhe [C. nr. 4/18]), pas përfundimit të procedurës së trashëgimisë në të cilën parashtruesi i kërkesës fitoi legjitimacionin aktiv në kërkesëpadinë e babait të tij të ndjerë R.K., për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat e kontestuar, e cila kërkesëpadë, sipas informatave deri në momentin e parashtrimit të kërkesës së tanishme më 30 maj 2025, ende është duke u shqyrtuar në gjykatën e shkallës së parë pas kthimit në rivendosje më 26 gusht 2024 nga ana e Gjykatës së Apelit. Në vijim të kësaj, Gjykata rikujton se ia ka njohur statusin e palës së autorizuar parashtruesit të kërkesës që nga fillimi i procedurës gjyqësore në lëndën e lartcekur, të iniciuar nga babai i tij, pavarësisht që kishte fituar legjitimacionin aktiv në vitin 2018.
70. Rrjedhimisht, periudha që do të merret parasysh nga Gjykata përfshin periudhën mbi 18 (tetëmbëdhjetë) vite.

A. Parimet e përgjithshme të kohëzgjatjes së procedurës

71. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”.
72. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se “Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”.
73. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
74. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshinë por nuk kufizohet në rastet (i) [KI142/23](#), parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025; [KI64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) [KI06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) [KI177/19](#), parashtrues *NNT “Sokoli”*, Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) [KI19/17](#), parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 shkurtit 2018. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ, përfshirë rastet (i) [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) [Poiss kundër Austrisë](#), nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) [Abdoella kundër Holandës](#), nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) [Comingersoll S.A. kundër Portugalisë](#), nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) [Mikulić kundër Kroacisë](#), nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) [Scordino kundër Italisë](#) (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) [Frydlender kundër Francës](#), nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) [Sürmeli kundër Gjermanisë](#), nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) [Mishqioni kundër Shqipërisë](#), nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) [Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë](#), nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.
75. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se (i) përlllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (rastet e Gjykatës [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 47, [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 82; dhe shih, rastet e GJEDNJ-së, [Poiss kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 50; [Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë](#), cituar më lart, paragrafi 74; [Comingersoll kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafi 24; dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 142; dhe).
76. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto

kritere kryesore: (i) ndërlikueshmëria e rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih, rastet e Gjykatës, [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65; dhe rastin e GJEDNJ-së, [Surmeli kundër Gjermanisë](#), cituar më lart, paragrafi 128) të cilat në mënyrë të përmblëdhur do të elaborohen në vijim.

77. Përkitazi me (i) ndërlikueshmërinë e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës, [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 49; dhe [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 66-67; dhe rastet e GJEDNJ-së, [Papachelas kundër Greqisë](#), nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe [Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 210).
78. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastin e Gjykatës [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 50; dhe rastet e GJEDNJ-së, [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 68; dhe [Union Alemnitaria Sanders S.A kundër Spanjës](#), nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 68-70).
79. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor; gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore të tjetra (shih, rastet e Gjykatës [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 51; dhe KI64/23, cituar më lart, paragrafi 71-73).
80. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen

me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*prirje të reduktuar të jetëgjatësisë*”; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, rastet e Gjykatës [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 52, dhe dhe [Kl06/21](#), cituar më lart, paragrafi 67).

B. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

81. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata rikujton se lënda civile, kohëzgjatjen e të cilës e konteston parashtruesi i kërkesës ishte iniciuar nga babai i tij në vitin 1997. Gjykata rithekson se ky rast ishte vendosur më 9 maj 2001 nga Gjykata Komunale, por ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Qarkut. Në procedurë të rigjykimit, kjo procedurë u ndërpre më 29 mars 2002 nga Gjykata Komunale, pas vdekjes së evidentuar të paditësit, respektivisht, babait të parashtruesit të kërkesës më 17 shtator 2001. Gjykata vëren që nga viti 2002 deri më 24 qershor 2015, kur parashtruesi i kërkesës së bashku me disa paditës (familjarë të parashtruesit) të tjerë, morën përsipër çështjen kontestimore, me ç’ rast kërkuan rikonstruktimin e shkresave të lëndës së lartcekur, Gjykata Themelore kishte qenë pasive. Ndërsa, prej momentit prej kur parashtruesi i kërkesës fitoi legjitimacionin aktiv në lëndën [C. nr. 3114/24] më 22 shkurt 2018, kohëzgjatjen e të cilës e konteston, Gjykata Themelore mori veprimet si në vijim: (i) më 28 mars 2018 mbajti seancën përgatitore ku kërkoi të merren provat përmes ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë dhe ndërtimtarisë; (ii) në harkun kohor ndërmjet 15 majit 2018 dhe 6 marsit 2019 mbajti 4 (katër) seanca shqyrtuese; (iii) më 6 mars 2019 dhe 7 maj 2019, mbajti seancat shqyrtuese ku u dëgjuan nëna e parashtruesit të kërkesës, vetë parashtruesi i kërkesës si dhe vëllezërit e tij; (iv) në harkun kohor ndërmjet 10 qershorit 2019 dhe 11 nëntorit 2019, mbajti edhe 4 (katër) seanca shqyrtuese, me ç’ rast palëve iu mundësua fjala përfundimtare; si dhe (v) më 16 dhjetor 2019, vendosi çështjen civilo-juridike, me ç’ rast aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë. Ashtu siç reflektohet në faktet e kësaj kërkesë, vlen të theksohet se seancat e caktuara ishin shtyrë vazhdimisht në gjykatën e shkallës së parë. Në anën tjetër, më 26 gusht 2024, sipas ankesës së palëve në procedurë, përfshirë parashtruesit e kërkesës, Gjykata e Apelit vendosi që këtë çështje juridiko-civile ta kthejë në rivendosje, duke prishë disa pika të aktgjykimit të lartcekur. Gjykata po ashtu vëren se në procedurën e rivendosjes, më 26 shkurt 2025, mbajti seancën përgatitore të kësaj çështjeje, procedurën e së cilës e ndërpreu për shkak të vdekjes së paditëses së parë, respektivisht nënës së parashtruesit të kërkesës.
82. Gjykata nënvizon se gjykatave të rregullta i ishin dashur më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) vite që të vendosin rastin ndonëse ende jo me aktgjykim të formës së prerë. Gjatë kësaj periudhe, Gjykata vë në pah se ishin zhvilluar dy procedura të gjykimit në shkallë të parë dhe se aktualisht, rasti gjendet në procedurë të rivendosjes në Gjykatën Themelore që nga 26 gushti 2024. Gjykata gjithashtu rithekson se Gjykata Themelore kishte ndërprerë procedurën gjyqësore më 21 nëntor 2017 fillimisht si rezultat i vdekjes së paditësit, R.K., respektivisht babait të parashtruesit të kërkesës dhe së fundi, nënës së tij, Sh.K. më 26 maj 2025.
83. Prandaj, pavarësisht veprimeve të ndërmarra nga ana e gjykatave të rregullta siç janë reflektuar më lart, Gjykata vlerëson se shkaku kryesor i kohëzgjatjes së tepruar të

procedurës në këtë rast është veprimi i ngadaltë dhe joefikas i gjykatave të rregullta, të cilat nuk kanë ndërmarrë masa adekuate për të zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë që shteti të mos përmbushë detyrimin e tij për sigurimin e të drejtës efektive për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

84. Në vijim, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtruesit të kërkesës, jo domosdoshmërisht hyn në ato kategori (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, [KI120/25](#), parashtrues *Mustafa Shefkiu*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2025, paragrafi 53).
85. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, [KI120/25](#), parashtrues *Mustafa Shefkiu*, cituar më lart, paragrafi 54).
86. Nga sa më sipër, marrë parasysh parimet e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të aplikuara në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurës së zhvilluar në lidhje me lëndën [C. nr. 3114/24] në Gjykatën Themelore prej më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) vitesh është e paarsyeshme, për shkak se: (i) çështja e parashtruesit të kërkesës nuk rezultoi të jetë e një natyre aq të ndërlikuar sa që do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e lëndës përkatëse të mos përfundojë as pas kaq shumë kohe; (ii) parashtruesi i kërkesës ishte relativisht aktiv në zgjidhjen e çështjes së tij; si dhe (iii) gjykatat e rregullta pavarësisht veprimeve procedurale që kishin ndërmarrë, e që karakterizohen edhe me shtyrjen e seancave, duke përfshirë edhe vendosjen e rastit më 16 dhjetor 2019 nga Gjykata Themelore dhe kthimin në rigjykim të çështjes nga ana e Gjykatës së Apelit më 26 gusht 2024, janë treguar të ngadalta dhe joefikase për të zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm.
87. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kohëzgjatja e procedurës për rastin e parashtruesit të kërkesës për më tepër se 18 (tetëmbëdhjetë) vite, ka shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
88. Gjykata thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të saj para gjykatave të rregullta.

II. Përkitazi me kërkesën për kompensim

89. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit për kompensim të dëmit material dhe jomaterial në shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë) euro, Gjykata ka përsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih, rastet [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 68).

90. Gjykata rithekson se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të “shpërblimit të drejtë”, sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih, rastin e Gjykatës KI142/23, cituar më lart, paragrafi 69).
91. Në këtë kontekst, në rrethana të rastit konkret, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur lëndën civile [C. nr. 3114/24] me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 23 prill 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë që jo më larg se 20 nëntor 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Safet Hoxha

Nexhmi Rexhepi